

AKT- MARRËVESHJE

Datë 30.01.2024

Sot, në datë 30.01.2024, nënshkruhet Akt-Marrëveshja midis palëve si më poshtë:

Pala e parë: Z. Plarent Ndreca, atësia Pjetër, datëlindja 27.05.1977, ID nr. personal H70527092N në cilësinë e ortakut të vetëm të Shoqërisë "T&N" Shpk.

dhe

Pala e dytë: Z. Albi Alimani, atësia Artur, datëlindja 20.01.1994, ID nr. personal J40120074N, në cilësinë e Personit të besuar.

Duke qenë se ekzistojnë faktet e mëposhtme:

- Z. Plarent Ndreca është ortak në Shoqërinë "T&N" Shpk me NUIS L81717029G, ku zotëron 100 % të kapitalit.
- Z. Plarent Ndreca cakton Z. Albi Alimani, si **Person të Besuar**.
- Z. Albi Alimani shpreh pëlqimin dhe deklaron se pranon caktimin si Person i Besuar.

Me vullnet të lirë e të plotë Palët deklarojnë se kanë vendosur të hartojnë Akt-Marrëveshjen me përmbajtjen si më poshtë, në bazë të Nenit 3 pika 6 dhe Nenit 35 i Ligjit nr. 9367/2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar.

NENI 1

Objekti i Akt-Marrëveshjes

Objekt i kësaj Akt-Marrëveshje është caktimi i Z. Albi Alimani në cilësinë e Personit të Besuar të ortakut Z. Plarent Ndreca, në Shoqërinë "T&N" sh.p.k. me numër identifikimi NUIS L81717029G, në përputhje me Nenin 27 dhe 35 të Ligjit Nr. 9367/2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar si dhe tagrave të specifikuara si më poshtë, si pasojë e humbjes së cilësisë si "**Zotërues aktiv i kuotave**", që ai zotëron në shoqëri, nëpërmjet transferimit të tyre dhe kalimit në cilësinë e "**Zotëruesit pasiv të kuotave**".

NENI 2


Afati i Akt-Marrëveshjes

Kjo Akt- Marrëveshje do të jetë në fuqi, sipas Ligjit Nr. 9367/2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar.

NENI 3

Të drejtat dhe detyrimet e palëve

- Me qëllim menaxhimin e aktivitetit të shoqërisë së mësipërme, nga momenti i nënshkrimit të kësaj Akt- Marrëveshje, ortakut Z. Plarent Ndreca i kalon në mënyrë individuale Personit të Besuar, të drejtën e vendimmarrjes mbi kuotat e zotëruara prej tij në këtë shoqëri.
- Menaxhimi dhe administrimi nga Personi i Besuar do të bëhet sipas legjislacionit në fuqi, por pa të drejtën e tjetërsimit të tyre. Gjithashtu me nënshkrimin e kësaj Akt-Marrëveshje, ortakut Z. Plarent



Ndreca humbet cilësinë si "Zotërues aktiv i kuotave", që zotëron në shoqërinë e mësipërme, duke kaluar në "Zotërues pasiv të kuotave të saj".

- Z. Plarent Ndreca, pavarësisht kalimit në "Zotërues pasiv të kuotave" të tij, gëzon të drejtën e përfitimit të fryteve civile të pronësisë që gëzon mbi kuotat e tij në shoqëri, por në çdo rast, nuk mund të ushtrojë asnjë veprim tjetër mbi këto pasuri.
- Personi i Besuar detyrohet të mos shkëmbejë asnjë informacion me ortakun e shoqërisë dhe të mos ndikohet nga ai në kryerjen e veprimeve me pasuritë e shoqërisë dhe mbarëvajtjen e aktivitetit të saj.
- Personi i Besuar detyrohet të veprojë vetëm në të mirën e ruajtjes së pasurive të shoqërisë me të njëjtin motivim sikur këto veprime të kryheshin nga vetë ortaku i saj, duke vepruar në mirëbesim.
- Palët detyrohen të kryejnë depozitimin e kësaj Akt-Marrëveshje pranë QKB-së, në të dhënat e shoqërisë së sipërcituar, si dhe pranë çdo institucioni shtetëror ku depozitimi i këtij akti është detyrim ligjor sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

NENI 5 Shpërblimi

Palët bien dakord që shpërblimi për shërbimin që do të kryhet nga Personi i Besuar do të vendoset me marrëveshje midis tyre.


NENI 6 Të ndryshme

Kjo Akt-Marrëveshje u hartua me vullnetin e të dyja palëve në 4 (katër) kopje.

Për sa nuk është parashikuar si më sipër, palët do t'i referohen dispozitave ligjore të parashikuara në Kodin Civil dhe Ligjin Nr. 9367/2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" I ndryshuar, si dhe çdo ligji tjetër në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Pala e parë

PLARENT NDRECA



Pala e dytë

ALBI ALIMANI

